

AMVV

# **RAPORTI** **VJETOR**

2019

**Agjencia për Mbështetjen e  
Vetëqeverisjes Vendore**

## **Përmbajtja**

- i. Parathënie**
- ii. Prioritetet e vitit 2019 dhe realizimi i tyre**
  - a. Rishikimi dhe përditësimi i Planit të Veprimit të Strategjisë së Decentralizimit**
  - b. Zbatim i detyrimeve për mbarëvajtjen e Zgjedhjeve Vendore**
  - c. Zyrat me Një Ndalesë (ONE STOP SHOP)**
  - d. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike**
  - e. Strategjia Antikorrupsion**
  - f. Ligji për Policinë Bashkiake**
  - g. Këshillat Vendor të Sigurisë**
- iii. Njësitë e Integritit Evropian**
  - a. Hapat e Ndërmarra nga Agjencia**
  - b. Zhvillime të tjera të cilat janë ndjekur nga AMVV**
- iv. Këshilli Konsultativ përgjatë vitit 2019**
  - a. Mbledhjet e Këshillit Konsultativ për Vitin 2019**
  - b. Matrica e kompetencave**
- v. Bashkëpunime me projekte në fushën e pushtetit vendor**
  - a. Kapacitetet administrative**
  - b. Shërbimet Vendore**
  - c. Demokracia Vendore: (Pjesëmarrja, Transparenca, Integriteti)**
  - d. Zhvillimi i përgjithshëm i burimeve njerëzore**
  - e. Harta Digjitale e Projekteve dhe Harta e Profileve të Bashkive**
- vi. Vlerësimi i Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore**
- vii. Prezantimi i Platformës së Rentës së Industrisë Nxjerrëse**
- viii. Rregullorja e Këshillave Bashkiak**
- ix. Sfidat**

## **I. Parathënie**

**Agjencia për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore** ka qenë nxitëse dhe mbështetëse ndaj NJQV-ve për realizimin në praktikë të reformës së Decentralizimit dhe përmirësimit të qeverisjes së mirë, përmirësimin e shërbimeve publike vendore, rritjes së transparencës, konsolidimin e funksioneve të transferuara tashmë drejt nivelit vendor, fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të NJQV, krijimin e standarteve kombëtare të shërbimeve publike, fuqizimin e organeve ekzekutive por edhe atyre përfaqësuese në nivelin vendor.

Reforma territoriale dhe administrative është tema qendrore e punës dhe aktivitetit të AMVV, vizioni dhe objektivat janë shumë ambicioze dhe përgjithësisht janë arritur me sukses. Shumë përpjekje u bënë për të mbështetur procesin e konsolidimit territorial, administrativ dhe financiar nga qeverisja qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë. Aktorët si në nivelin qendror ashtu dhe në atë vendor besojnë se reforma ka bërë që bashkitë të rrisin aftësitë e tyre menaxheriale, kapacitetin e planifikimit të integruar dhe të tërheqin staf më të kualifikuar, të rrisin kapacitetet për rritjen e të ardhurave nga burimet e veta, si dhe të sigurojnë shërbime më cilësore për qytetarët e tyre dhe të rrisin shkallën e mbulimit me shërbime.

AMVV ka kontribuar në vijimësi për plotësimin e akteve ligjore e nënligjore në funksion të reformës së decentralizimit, duke kërkuar nga Ministritë e Linjës përmirësimin dhe plotësimin e tyre, bazuar kjo në Strategjinë e Decentralizimit dhe Matricën e Kompetencave Vendore.

Plani i veprimit të Strategjisë së Decentralizimit hap një prespektive të re në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve, të cilat me këtë synojnë drejt konsolidimit të Njësive të reja të Vetëqeverisjes Vendore.

### **ii. Prioritetet e vitit 2019 dhe realizimi i tyre**

## **a. Rishikimi dhe përditësimi i Planit të Veprimit të Strategjisë së Decentralizimit**

Procesi i përditësimit dhe rishikimit të Planit të Veprimit ka filluar në Shkurt të vitit 2019 dhe procesi i rishikimit dhe përditësimit nga pikëpamja teknike zgjati deri në Korrik 2019. Ky proces përfshiu ndër të tjera

1. (i) shqyrtimin e dokumenteve të identifikuar dhe përgatitjen e planit operativ për rishikimin e planit të veprimit,
2. (ii) konsultime me ekspertë teknik në nivel ministrie linje dhe aktorësh të tjerë (bazuar në shkresat e dërguara nga institucionet mbi përfaqësuesit e tyre në grupin tematik të decentralizimit) për të rishikuar planin e veprimit respektiv,
3. (iii) përgatitja e draftit të parë të Planit të Veprimit dhe
4. (iv) konsultime dhe validim gjetjesh mbi Planin e Veprimit të rishikuar dhe të përditësuar.

Konsultimi është kryer jo vetëm nëpërmjet Grupit Tematik të Decentralizimit, i cili ka në përbërje staf teknik nga të gjithë Ministrinë e Linjës dhe partnerë zhvillimi, por edhe duke përdorur platforma të konsultimit publik. Kjo e fundit me qëllim përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në konsultimin e këtij plani. I gjithë procesi i rishikimit të Planit të Veprimit është bërë në përputhje me sugjerimet e Ministrive të Linjës dhe agjencive shtetërore, dhe në përputhje me rekomandimet e Bashkimit Evropian mbi pushtetin vendor.

Vëmendje më e madhe është kushtuar procesit intensiv të konsultimit me Ministrinë e Linjës, Agjencitë Shtetërore, Donatorët dhe aktorët, proces i udhëhequr nga Ministria e Brendshme dhe AMVV, që rezultoi në një version të konsoliduar të Planit të Veprimit të NCSDLG. Tre Grupe Tematike të Decentralizimit (TGD) u organizuan për të përfshirë anëtarët e këtij grupi në të gjitha fazat e hartimit të këtij plani të veprimit. Të gjitha komentet dhe sugjerimet janë adresuar në përputhje me rrethanat në draftin ekzistues të planit. Versioni i azhurnuar dhe i rishikuar i Planit të Veprimit përmban katër objektiva kryesore, të cilat orientojnë procesin e decentralizimit në Shqipëri. Këto objektiva janë kostuar dhe shoqërohen me indikatorë për matjen e performancës. Objektivat janë:

- a) Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- b) Forcimi i financave lokale dhe autonomisë fiskale;
- c) Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm lokal;
- d) Forcimi i qeverisjes së mirë në nivelin lokal.

Aktualisht ky plan veprimi mbetet akoma në proces miratimi nga Këshilli i Ministrave. Nga këndvështrimi i AMVV-së, janë marrë të gjitha masat për të rishikuar nga pikëpamja teknike planin e vjetër të veprimit të SKNDQV dhe gjithashtu përditësuar deri në vitin 2022.

## **b. Zbatim i detyrimeve për mbarëvajtjen e Zgjedhjeve Vendore**

AMVV ka ndjekur zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Brendshëm lidhur me procesin zgjedhor, e cila lidhet edhe me prioritetin nr.6 të Ministrisë së Brendshme, specifikisht nr.6.4 “Zbatim i detyrimeve për mbarëvajtjen e Zgjedhjeve Vendore”. Në mënyrë të detajuar, raportohet se AMVV ka punuar mbi plotësimin e matricës për monitorimin e procesit të Zgjedhjeve Vendore për Vitin 2019, duke mbajtur kontakt të drejtpërdrejtë me të gjitha bashkitë e vendit, bazuar në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.395, datë 10.05.2019 “Për krijimin dhe funksionimin e Task-Forcës për marrjen e masave të nevojshme për menaxhimin e procesit zgjedhor” e cila kishte si detyrë monitorimin e zbatimit nga ana e Kryetarëve të Bashkive detyrimeve që rrjedhin nga Kodit Zgjedhor për krijimin e kushteve në këtë proces, si më poshtë vijon:

- a) Caktimi i nëpunësit ndërlidhës me KQZ;
- b) Shpallja e listave të hartuara nga Zyra e GJC;
- c) Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë sipas qendrave të votimit;
- d) Lajmërim me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore;
- e) Heqje nga listat e zgjedhësve të personave mbi 100 vjeç dhe atyre që kanë ndërruar jetë deri datën e shpalljes së listave zgjedhore;
- f) Caktimi dhe shpallja e vendndodhjes së qendrave të votimit.

Në vijim të përmbushjes së detyrave funksionale, AMVV në bashkëpunim me Drejtorinë e Prefekturave dhe Çështjeve Vendore, ndoqi me prioritet konstituimet dhe dorëzoi dosjen me manualin e punës për çdo Kryetar Bashkie, sipas programit të përcaktuar nga Drejtoria e Prefekturave dhe Çështjeve Vendore dhe AMVV mbi konstituimin e këshillave bashkiak dhe betimin e Kryetarëve të Bashkive të dalë nga zgjedhjet e 30 Qershorit 2019. AMVV ishte pjesëmarrëse në këshillimin dhe ndjekjen e procedurave mbi konstituimin dhe marrjen e detyrës nga këshilltarët e rinj si dhe nga kryetarët e bashkive. Në vazhdim, për dorëzimin e manualit të punës tek të gjithë kryetarët e bashkive të dalë nga zgjedhjet e 30 Qershorit 2019.

### **c. Zyrat me Një Ndalesë (ONE STOP SHOP)**

Agjencia është pjesë e zbatimit të Sistemit Informativ të Zyrave me Një Ndalesë (OSSH), për ofrimin e shërbimeve administrative vendore. AMVV në bashkëpunim me Projektin STAR 2 vazhdojnë të zhvillojnë aktivitete, inspektime si dhe mundësojnë asistencë mbi "Konsolidimin e Projektit të Reformës Administrative Territoriale". Kjo asistencë përfshin analizat, hartimin, zhvillimin, vendosjen, trajnimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen e përdoruesve. Kjo për ti ardhur në ndihmë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Në vitin 2019 janë ngritur 28 njësi të One Stop Shop të ngritura në bashkitë si më poshtë:

Maliq, Librazhd, Cërrik, Malësi e Madhe, Përmet, Mallakastër, Vorë, Blesh, Skrapar, Lushnje, Gramsh, Tepelenë, Tropojë, Delvinë, Konispol, Durrës, Krujë, Kurbin, Rrogozhinë, Shijak, Divjakë, Memaliaj, Dropull, Bulqizë, Libohovë, Devoll, Kamëz, Kukës, Kavajë.

**Tabela 3: Numri i OSSH në 2018 dhe 2019**

<b>Numri i OSSH në 2018</b>	<b>Numri i OSSH në 2019</b>
3	28

Numri i OSSH është rritur në mënyrë proporcionale gjatë vitit 2019, jo vetëm falë bashkëpunimit me AMVV, por dhe për ngritjen fizike dhe teknologjike të këtyrë zyrave, pas studimeve të fizibilitetit realizuar gjatë 2018. Ndërkohë, puna për ngritjen e Zyrave me Një Ndalesë për bashkitë e tjera është në vijim.

#### **d. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike**

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratës Publike (SNRAP), Departamenti i Administratës Publike ka hartuar Raportin vjetor të monitorimit të SNRAP për vitin 2019. AMVV ka punuar dhe ka dhënë kontributin e saj për periudhën Janar-Dhjetor 2019 mbi: Mbështetjen dhe funksionimin e NJVV-ve, forcim të kapaciteve zbatuese si dhe Krijimin e “Zyrave me Një Ndalesë” për shërbimet administrative në nivel vendor.

AMVV, ka qenë pjesë e takimeve të Grupeve Tematike për Reformën në Shërbimin Civil dhe SNRAP dhe ka dhënë kontributin e saj në nivel teknik.

#### **e. Strategjia Antikorrupsion**

Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar përgatitja e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes. Materialet i janë nënshtruar konsultimit publik dhe më pas janë reflektuar të gjitha sugjerimet e mbledhura gjatë këtij procesit të konsultimit. Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit dhe Kodi Standard i Sjelljes i janë dërguar për mendim dhe ILDKPK, KDIMDP dhe MD të cilat kanë shprehur vlerësimin e tyre mbi materialet e paraqitura.

Gjatë vitit 2019, janë organizuar 4 takime Informuese rajonale në qytetet: Tiranë, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, ku morën pjesë përfaqësues të 61 bashkive dhe prefekturave të vendit. Në takimet rajonale, u prezantuan: a) Metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Integritetit (Metodologjia VRI) për Vetëqeverisjen Vendore; b) Modeli Standard i Kodit të Sjelljes. Takimet u kryesuan nga Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK) dhe Ministria e Brendshme/ Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), organizuar nga IDM.

Gjithashtu, janë organizuar takime koordinuese me 6 Bashkitë (Elbasan, Mat, Patos, Mallakastër, Gjirokastrë dhe Durrës) të cilat kanë dalë vullnetare për të pilotuar metodologjinë e riskut të integritetit.

Në aktivitet u prezantuan zhvillimi i planeve të integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore (procesi i vlerësimit të riskut të integritetit në nivel vendor). Këto produkte janë realizuar në kuadër të projektit STAR-2 të UNDP Albania për forcimin e etikës dhe integritetit në qeverisjen vendore, përfshirë metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit dhe kodin standard të sjelljes për Qeverisjen Vendore.

Planet e integritetit, të pilotuara në 6 bashkitë e vendit, pritet të ndikojnë në reduktimin e rrezikut të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në nivel vendor duke forcuar demokracinë, llogaridhënien dhe duke përmirësuar transparencën e bashkive.

Me vendim të Këshillave Bashkiak janë miratuar planet e integritetit për Bashkinë Elbasan, Mat, Mallakastër dhe Patos. Ndërsa për Bashkinë Durrës dhe Gjirokastrë është përfunduar hartimi i planeve respektive të integritetit dhe pritet miratimi i tyre nga Këshillat Bashkiak.

#### **f. Ligji për Policinë Bashkiake**

Draft- Ligji i Policisë Bashkiake, sipas versionit të ligjit të policisë Bashkiake Çeke, është në proces konsultimi. Është në përfundim ky draft, sipas porosisë së Ministrit, i cili është dërguar për konsultim në zyrën juridike të Ministrisë Brendshme. AMVV ka qenë në kontakte të vazhdueshme me Drejtorinë e Prefekturave dhe Çështjeve Vendore për konsultimin e draftit të ligjit për Policinë Bashkiake.

#### **g. Këshillat e Sigurisë**

Bazuar në VKM nr. 83, datë 28.01.2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, pika 3/d e nenit 11, pika 2 e nenit 78 dhe neni 79 të Ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në funksion të detyrave të AMVV-së është u është komunikuar dhe sugjeruar bashkive ngritja e Këshillave Vendore Për Sigurinë Publike. Materialet për ngritjen dhe funksionimin e këtyre Këshillave janë dërguar nga ana e Agjencisë, sipas modelit të Bashkisë Elbasan.

Rezulton që 53 bashki të vendit e kanë krijuar Këshillin Vendor Për Sigurinë Publike. Bashkitë të cilat akoma nuk e kanë një këshill të tillë, janë si më poshtë:

- 1- Kurbin
- 2- Peqin
- 3- Libohovë
- 4- Memaliaj
- 5- Tepelenë
- 6- Selenicë
- 7- Shkodër
- 8- Poliçan

Bashkitë që nuk e kanë ngritur akoma Këshillin Vendor për Sigurinë Publike, janë kontaktuar nga AMVV, duke dërguar e ridërguar materialet orientuese për krijimin e këtij këshilli që shërben për përmirësimin e sigurisë në nivel vendor.

### **iii. Njësitë e Integritit Evropian**

Duke marrë parasysh vështirësitë në kuptimin e rolit të Njësitë të Integritit Evropian (NjIE) fokusi dhe puna e AMVV konsiston në ngritjen e NjIE sipas kërkesave të VKM 450/2018. Në zbatim të kësaj VKM-je, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, ka qenë

gjatë vitit 2019 e angazhuar në ngritjen e grupeve të punës për ta monitoruar më nga afër procesin në çdo bashki të vendit. Ndërmjet Agjencisë dhe projektit “Bashkitë për në Evropë”, është nënshkruar dhe një “Letër Angazhimi” për Funksionimin dhe Menaxhimin e Platformës së Internetit. Anëtarët dhe funksionimi i Platformës u rritën brenda një viti dhe kanë arritur një numër prej 130 abonentësh, kryesisht të stafit të bashkive (njësitë e BE-së).

AMVV-ja lëshoi një urdhër më 23 Janar 2019, pasuar kjo dhe me takime e kontakte me kryetarët ose me koordinatorët lokalë të BE-së. Deri më 28 shkurt 2019 Njësitë e BE-së u ngritën në 61 bashkitë e vendit. Agjencia asistoi bashkitë për nxjerrjen e urdhrat sipas kushteve të kërkuara nga Delegacioni i BE-së, si VKM nr. 456. Ndihma dhe orientimi i kryetarëve të rinj të zgjedhur për të kuptuar rolin e NjIE dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së stafit të NjIE pas zgjedhjeve lokale të Qershorit 2019 ka qenë thelbësore për AMVV.

***a. Hapat e Ndërmarra nga Agjencia:***

Nga Korriku 2019 - Shkurt 2020, AMVV ka informuar të gjithë kryetarët e rinj të zgjedhur për VKM 450, për rolin e NjIE dhe rëndësinë e qëndrueshmërisë së stafit. Informimi është pasuar me kërkesa zyrtare Nëntor 2019 dhe Shkurt 2020 për dokumentacionin për ngritjen e NjIE. Ndjekja me secilin kryetar në mënyrë individuale e procesit të përfundimit të njërive të mbetura dhe vizita në bashkitë problematike ka rezultuar e suksesshme për ngritjen e këtyre njërive.

Për shkak të zgjedhjeve vendore, AMVV ka monitoruar largimit / zëvendësimit të stafit pas zgjedhjeve vendore. Nga monitorimi i bërë, rezulton se stafet në bashki kanë qenë stabil. Me gjithë ndryshimin e udhëheqjes politike në 37 bashki (ose 67%) ndryshimet e stafit të NjIE për shkak të ndryshimeve politike kanë ndodhur vetëm në 5 bashki (ose 8%). Në fakt, rrogat e ulta janë arsyeja kryesore e largimit të stafit. Si më poshtë informacion i detajuar mbi largimin e stafit, për të gjithë 2019 (jo vetëm periudha e zgjedhjes):

- Mars 2019 deri në 1 mars 2020: largimi i stafit në 20 bashki (ose 33%):
- 5 u larguan për arsye politike
- 8 për arsye emigrimi
- 6 janë larguar të punojnë në sektorin privat ose organizata ndërkombëtare
- 1 u largua për performancë të dobët.

Gjithashtu, AMVV ndjek edhe standardet e ngritjes së NjIE. Nga monitorimi në 2019, rezulton se:

- 13 bashki kanë krijuar NjIE sipas kërkesave të VKM 450;
- Numri i bashkive të cilat nuk kanë paraqitur asnjë akt juridik për themelimin e NjIE-së ka rënë nga 26 në Korrik 2019 në 16 në Shkurt 2020
- 32 bashki kanë krijuar NjIE, por dokumentet zyrtare për emërimin e stafit pritet ende të dorëzohet pranë AMVV-së.
- Vlerësimi i Performancës - Mapping monitorimi dhe ndjekja nga AMVV:



Ndërkohë, gjatë 2019 është bërë edhe vlerësimi i 2-të, pra i 2018, i cili përfundoi në Shtator 2019. Ndërsa, vlerësimi i 3-të: 2019 filloi në Nëntor 2019 dhe mbaroj në 2020. Në të dyja rastet, AMVV ka mbledhur, hedhur dhe përpunuar për të monitorimin e bashkive. Përdorimi i Sistemit Online të Raportimit reduktoi gabimet dhe shkurtoi kohën e raportimit. Më konkretisht, hedhja e të dhënave u realizua në masën 99.93% për të gjithë treguesit. Procesi i futjes së të dhënave është përfunduar me 20 ditë vonesë (për shkak të tërmetit) në krahasim me 2 muaj vonesë në 2018 dhe 4 muaj vonesa në 2019.

**b. Zhvillime të tjera të cilat janë ndjekur nga AMVV:**

- 9 trajnime rajonale të organizuara nga ASPA në bashkëpunim me AMVV dhe mbështetjen e Projektit MfE për më shumë se 100 staf të NjIE.
- Me mbështetjen e TAIEX, u organizua një vizite studimore në Slloveni me 5 përfaqësues të NjIE dhe 1 të AMVV.
- Në 8 nëntor 2019 u organizua takimi i përbashkët i NjIE në bashki dhe ministritë e linjës që synon krijimin e një mekanizmi koordinimi midis dy niveleve

Bashkitë me anë të asistencës dhe bashkëpunimit të AMVV-së arritën të vlerësohen dhe të japin një shembull unik për realizimin e aktiviteteve të Javës së Evropës, ku u zhvilluan 95 evente në 61 Bashkitë e vendit. Një shifër kjo e cila u përgëzua dhe u vlerësua si një arritje e vendit tonë.

Funksionimi i Platformës Intranet: 181 postime në 6 muajt e fundit në lidhje me Cfp, Mapping ose tema të tjera, ka ndihmuar edhe koordinimin me bashkitë lidhur me NjIE. Platforma kryesisht përdoret për të ndarë informacione mbi ngjarjet e organizuara nga Njësitë e Integritit Evropian në çdo bashki, prezantimet dhe informatat mbi programet e ndryshme të BE-së, ndarjen e praktikave më të mira etj. Pyetjet e qytetarëve për çështje të ndryshme që lidhen me BE-në adresohen përmes platformës, për të cilën AMVV ka bashkëpunuar me Ministritë e Linjës dhe organet kompetente sipas pyetjeve të drejtuara dhe ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve.

AMVV së bashku me projektin “Bashki për Evropë” ka ofruar asistencë për ngritjen e strukturave të Integritit Evropian në nivelin vendor. Produktet e realizuara janë:

- Krijimi i Këndeve të Informimit të BE-së në 61 bashkitë të cilat u pajisen me elemente të dukshmerisë dhe u instaluan në hyrje të secilës bashki
- Institucionalizimi i Këndeve të BE-së dhe transformimi i tyre në Njësitë për Koordinimin e Procesit të Integritit Evropian dhe Ndihmës e Huaj.
- Krijimi i Rrjetit të Koordinatorëve Lokal të BE-së: 61 Koordinatorët Vendorë të BE-së tani kanë krijuar rrjetin i cili zyrtarisht është nisur në ceremoninë e 9 Nëntorit 2018, në rastet e shpërndarjes së certifikatave të trajnimit.
- Trajnimi i 61 Koordinatorëve Vendorë të BE mbi politikat e BE-së dhe programet e BE-së (faza e parë)
- Mbështetje bashkive për procesin e aplikimit për fonde të BE-së, ku AMVV ka komunikuar dhe ka zhvilluar takime me bashkitë duke i informuar dhe adresuar se ku dhe si duhet të përthithin fondet.

- Vlerësimi i dytë 2018 dhe vlerësimi i tretë 2019. Organizimi i konferencave kombëtare për prezantimin e gjetjeve
- Ngritja e platformës online të komunikimit “Platforma Bashkitë për në Evropë”

Përgjatë vitit 2019 arritjet e AMVV-së në bashkëpunim me BPE mbi 61 Bashkitë e Shqipërisë:

- Organizmi i 400 aktiviteteve me qytetarët për t’i informuar për politikat e BE-së, simbolet dhe historinë e BE-së, mundësitë e financimeve nga BE.
- Prodhimi i 5 publikimeve me tematike fondet e BE-së dhe rolin e bashkive në procesin e integritit evropian.

Nga 61 bashki 45 prej tyre kanë zhvilluar dhe raportuar për natyrë të ndryshme të aktiviteteve siç janë; 25 aktivitete janë për fëmijët, 143 për të rinjtë, 2 për fermerët, 21 për administratën e qeverisjes vendore, 2 për biznesin, 8 për qytetarët, 2 për gratë, 0 për personat me aftësi të kufizuara, 2 për njerëzit e moshuar, 35 në grupet mix, 15 në BE histori dhe simbole, 25 për Informacionin mbi Tavolinën e BE-së, 14 për mjedisin, 5 për migracionin e paligjshëm, 9 për zhvillimin ekonomik, 18 për demokracinë dhe të drejtat e njeriut, 11 aktivitete janë Informacion për financimin e BE-së, 18 për perspektivën shqiptare në BE, 5 për lëvizshmëri dhe transporti, 19 për turizëm dhe trashëgimi kulturore, 17 për shëndetin dhe mbrojtjen sociale, 36 për angazhimin e komunitetit dhe vullnetarizmin, 4 në tregun e brendshëm dhe 51 në javën e BE.

Gjatë vitit të kaluar (Janar-Dhjetor 2019), bazuar në raportet e paraqitura, 2601 njerëz kanë vizituar Qendrat e Informimit të BE-së në komuna. Komunat Vore, Gjirokastra dhe Mirdita, janë ato me një mesatare prej 200 vizitorësh secila, e ndjekur nga Patos, Përmeti, me një gamë prej 150-200, Himarë, Belsh, Durrës, Kurse, Pogradec, Përrenjas me një gamë prej 75-150 vizitorë, Elbasan, Berat, Dibër, Dropull, Fier, Gramsh, Kamëz, Këlcyre, Kurbin, Lezhe, Librazhd, Mallakastër, Mat, Memaliaj, Peqin, Përrenjas, Roskovec, Tepelenë dhe Vorë me një interval nga 10-75 dhe i fundit kategori me një gamë nga 2-10 vizitorë si Bulqizë, Rrogozhinë, Shijak, Shkodër dhe Ura Vajgurore.

#### **iv. Këshilli Konsultativ përgjatë vitit 2019**

Këshilli Konsultativ është forumi kryesor konsultues ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore. Me qëllim institucionalizimin e procesit të konsultimit mes vetëqeverisjes vendore dhe qeverisjes qendrore, Këshilli Konsultativ ka për objekt konsultimi të gjitha projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projekt-politikat dhe projekt-strategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Synimi afatgjatë i krijimit dhe konsolidimit institucional të kësaj strukture është shndërrimi i organeve të vetëqeverisjes vendore në partnerë të rëndësishëm dhe të denjë të qeverisjes qendrore për fushat e tyre të përgjegjësisë dhe të drejtave që gëzojnë.

Procesi i konsultimit në Këshillin Konsultativ bazohet në:

- a) parimin e informimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe nëpërmjet tyre, të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore për projektligjet, projektvendimeve, projekt politikave ose projekt strategjive që propozohen nga qeverisja qendrore;
- b) parimin e këshillimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projektligjet, projektaktet nënligjore, projekt politikave ose projekt strategjitë të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- c) parimin e angazhimit të shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të vetë këtyre njësive, si dhe rritjen e transparencës, nëpërmjet përfshirjes së tyre në procesin e formulimit dhe miratimit të projektakteve, politikave dhe zgjidhjeve konkrete.
- ç) parimin e bashkëpunimit dhe dialogut konstruktiv me të gjithë shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

#### **a. Mbledhjet e Këshillit Konsultativ për Vitin 2019**

Këshilli Konsultativ përgjatë periudhës së vitit 2019 ka zhvilluar 6 takime, në Janar, në Shkurt, në Prill, në Shtator dhe në Nëntor. Ku janë konsultuar në total janë 54 projektakte, ndër to 47 të miratuara dhe 7 të pa prezantuara. Gjithashtu AMVV-ja ka bashkëpunuar Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë mbi realizimin e Këshillit Konsultativ “Për miratimin e buxhetit për vitin 2020 të NJQV”

##### **Të pa prezantuara:**


- Prezantimin me temë: PARKU REKREATIV, Mjedisi i munguar i qytetit tim.
- Projektligji “Për shërbimet e pagesave”
- Projektligji “Për investimet”
- Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e varrezave të dëshmorëve të atdheut”
- Projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr.426, datë 09.07.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit, “të ndryshuar.”
- Projektvendimin “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”.
- Projektvendimin “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”.

Në formë tabelore paraqesim pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit Konsultativ përgjatë vitit 2019 (shih Tabelën nr.1) dhe në paraqitje grafike tek Figura 1 dhe 2.

#### **Tabela 1: Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Konsultativ gjatë 2019 sipas anëtarëve**


	Mbledhja1	Mbledhja2	Mbledhja3	Mbledhja4	Mbledhja5	Mbledhja6	Mbledhja7	Mbledhja8	Mbledhja9	Mbledhja10	Mesatarja
Pjesemarrja nga Niveli Qendror	6	4	6	4	4	-	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	
Pjesemarrja nga Niveli Vendor	35	25	38	48	48	46	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	
Pjesemarrja e Kryetareve te Bashkive	3	1	4	9	9	16	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	
<b>Pjesemarrja ne Total</b>	44	30	48	61	61	62	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	
% e Pjesemarrjes ne cdo mbledhje te QQ ( sipas VKM)	67%	44%	67%	44%	44%	0%	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	53%
% e Pjesemarrjes ne cdo mbledhje te QV ( sipas VKM)	389%	278%	422%	533%	533%	511%	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	431%
% e Pjesemarrjes ne cdo mbledhje ne total	244%	167%	267%	339%	339%	344%	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	<b>242%</b>
Mesatarja	66%	66%	66%	66%	66%						
<b>Pjesemarrja e QV sipas VKM</b>											
Pjesemarrja e SHASH	3	2	3	7	7	2	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	
Pjesemarrja e SHBSH	0	0	0	0	0	-	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	
Pjesemarrja e SHKQSH	2	2	3	3	3	1	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	
Pjesemarrja e Kryetareve te Bashkive	3	1	4	7	7	16	#REF!	#REF!	#REF!	#REF!	

Figura 1 Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Konsultativ gjatë 2019 sipas anëtareve



Siç shihet nga Figura 1, nga mbledhja e pare e deri tek mbledhja e gjashtë, numri i pjesëmarrësve ka ardhur në rritje. Kjo gjë vërehet për anëtarët e Qeverisë Qendrore dhe atyre në nivel vendor (numri i kryetarëve të bashkive nga mbledhja e parë në të fundit është rritur nga 3 në 9).

Figura 2 Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Konsultativ gjatë 2019 në përqindje




Bashkëlidhur kësaj shkrese në formë tabelore (Tabela 2) dhe grafike (Figura 3) paraqiten të gjitha aktet e Këshillit Konsultativ të konsultuara në 2019 sipas Ministrive të Linjës.

**Tabela 2: Projektaktet e konsultuara në 2019 sipas Ministrive të Linjës**

MBLEDHJET E KËSHILLIT KONSULTATIV					
	MINISTRITË	TË MIRATUARA	TË PA PREZANTUARA	TË TËRHEQURA	TOTAL
1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	18			18
2	Ministria e Drejtësisë	1	2		3
3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	10			10
4	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	12			12
5	Ministria e Brendshme	3			3
6	Ministria e Mbrojtjes		1		1
7	Prezantime	4	1		5
	<b>TOTAL</b>	48	4		52

**Figura 3: Projektaktet e konsultuara në 2019 sipas Ministrive të Linjës dhe statusit të çdo projektakti**



## Produkti i Arritur

Mbledhjet e Këshillit Konsultativ kanë:

- Institucionalizuar procesin e konsultimit mes Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore duke informuar të gjithë palët për projektvendimet, projektligjet dhe projekt strategjitë që propozohen nga Qeverisja Qendrore.
- Realizuar mbledhjen e vërejtjeve, mendimeve, komenteve dhe propozimeve të bashkive dhe ia kanë bashkëlidhur praktikës dokumentare që shoqëron procesin vijues të vendimmarrjes përkatëse në Këshillin e Ministrave ose në Kuvend.
- Miratuar projektvendime që prekin funksionet dhe interesat e bashkive.
- Njohur paraprakisht Njësitë e Qeverisjes Vendore me masat që duhet të ndërmerren në kuadër të zbatimit të Ligjeve dhe VKM-ve.
- Rritur transparencën duke përfshirë shoqatat dhe bashkitë në procesin e formulimit të projekt – akteve ose projekt-ligjeve.

### b. Matrica e Kompetencave

Në vijim të studimit të financuar nga BE "Matrica e Kompetencave", AMVV në bashkëpunim me ekspertizën e BE-së dhe Ministrinë e Brendshme ka marrë pjesë në studim për të identifikuar aktet nënligjore që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme në 2019. Në këtë kontekst, ka ndodhur një proces konsultimi me ministrinë e linjës, proces i cili ka ndodhur paralelisht me rishikimin / përditësimin e Planit të Veprimit nga ekspertët.

Në përgjithësi, kontributi i AMVV ka qenë në identifikimin e mungesave, përplasjeve dhe paqartësive të bazës ligjore lidhur me funksionet e deleguara tek pushteti vendor. Në identifikimin e problematikave ligjore të sipërcituara, mbledhjet e Këshillit Konsultativ kanë shërbyer si platformë në të cilën gjithmonë janë evidentuar problematika, të cilat janë përfshurë në studim. Përveç sugjerimeve nga Këshilli Konsultativ, grupi i punës ka zhvilluar intervista të thelluara me teknikë të Ministrive të Linjës. Ky studim ka synuar konsolidimin

dhe harmonizimin e kuadrit ligjor dhe institucional sektorial dhe si rrjedhojë arrihet efikasiteti më i madh i veprimtarisë së njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore.

Gjithashtu, AMVV ka organizuar në 2019 konsultim të detajuar me teknikë të Ministrive të Linjës lidhur me rekomandimet e Matricës së Kompetencave. Sugjerimet e takimit konsultues u adresuan në versionin final të studimit të Matricës së Kompetencave.

Në korrik 2019, matrica e kompetencave është përkthyer në Urdhrin e Kryeministrit nr.101, datë 03.07.2019, ndjekjen e të cilit e bën DCVP. Kontributi i AMVV ka qenë i nivelit teknik për identifikimin e mospërputhjeve, mbivendosjes dhe mungëses së bazës ligjore. Në Urdhrin e Kryeministrit, parashikohet që të gjitha ministritë e linjës t'i raportojnë Ministrisë së Brendshme për zbatimin e akteve nënligjore që lidhen më pushtetin vendor.

AMVV ka ndjekur zbatimin e këtij urdhri nga Këshilli Konsultativ, duke qenë së çdo projektakt që ka lidhje me funksionet e deleguara pushtetit vendor dërgohet për konsultim në Këshill Konsultativ.

## **v. Bashkëpunime me projekte në fushën e pushtetit vendor**

Gjatë periudhës së zbatimit, projekti STAR2 ka patur arritje të konsiderueshme në të tre komponentet e tij. Këto arritje janë në përputhshmëri me përparësitë e reformës në qeverisjen vendore dhe kanë kontribuar ndjeshëm në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale përse Decentralizim dhe Qeverisje Vendore.

Rezultatet kryesore sipas tre komponentëve të Projektit STAR 2, në bashkëpunim me AMVV-në renditen si më poshtë:

### **a. Kapacitetet administrative**

- Rreth 195 nëpunës të administratës kanë përfituar nga trajnimet mbi Kodin e Procedurave Administrative dhe hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit;
- 37 Procedura Standarde të Veprimit (PSV) mbi buxhetin dhe financën, prokurimet publike dhe menaxhimi i burimeve njerëzore janë hartuar me kontributin e 9 bashkive pilote nëpërmjet asistencës në vendin e punës. Praktika ju shpërnda edhe 51 bashkive të tjera përmes ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve kryesorë, përveç Tiranës që ka përparuar ndjeshëm në zhvillimin e PSV.
- Rreth 107 punonjës të pushtetit vendor janë trajnuar për çështje të menaxhimit të pasurive dhe menaxhimit të tokës, një çështje me interes të veçantë për bashkitë;
- 162 nëpunës të financave, auditimit dhe prokurimit nga të 61 bashkitë kanë përfituar nga 9 trajnime rajonale 2-ditore. Gjithashtu, për zyrtarët e interesuar të qeverisjes vendore është vënë në dispozicion një udhëzues informues;

- Si pjesë e mbështetjes dhënë Udhëheqjes së Qeverisjes Vendore, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi për modelet dhe praktikatat e suksesshme, janë identifikuar dhe janë kataloguar në një broshurë praktikatat e mira bashkiake (të mandatit të kaluar);
- Të gjitha bashkitë u pajisën me Manualin Praktik për Procedurat e Administrimit Fiskal në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;
- Janë zhvilluar planet e veprimit dhe të monitorimit për mbledhjen e të ardhurave vendore për 29 bashki të vogla dhe të mesme;
- U dorëzuan 3 modele të strukturave organizative të bashkive sipas orientimit nga Ministria e Brendshme, DAP dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

### ***b. Shërbimet Vendore***

- Sistemi Informatik i Zyrës me Një Ndalesë (OSSIS): Pas procesit të pilotimit në 3 bashki, OSSIS është funksional në 31 bashki, duke e çuar numrin e përgjithshëm të bashkive me sistem funksional në 34: Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Durrës, Shijak, Krujë, Kurbin, Malësi e Madhe, Kukës, Tropojë, Bulqizë, Elbasan, Belsh, Gramsh, Cërrik, Librazhd, Përmet, Tepelenë, Memaliaj, Maliq, Kolonjë, Devoll, Pogradec, Delvinë, Konispol, Libohovë, Dropull, Skrapar, Poliçan, Mallakastër, Lushnjë, Divjakë. Bashkia e Tiranës ishte e para që u bë funksionale, një arritje e jashtëzakonshme me mbi 130 shërbime të ofruara.
- 9,582 aplikime janë regjistruar në sistem dhe 80% e tyre ofrohen nëpërmjet OSSIS;.
- Gjithsej, 76 shërbime vendore janë kataloguar, standardizuar dhe rrjedhat e punës janë optimizuar dhe zbatohen nëpërmjet OSSIS;.
- Gjithsej, 1470 nëpunës bashkiakë janë trajnuar për përdorimin e OSSIS.
- Një arritje e rëndësishme që lidhet me qëndrueshmërinë e OSSIS është prokurimi i një databazë moderne për të dhënat, si dhe pajisje dhe programe moderne, me licenca të përjetshme, të cilat ruhen në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (NAISASIG).
- 6 nga zyrat ofrojnë shërbime të pushtetit vendor dhe qendror në të njëjtin ambient me ADISA, në bashkitë Maliq, Belsh, Librazhd, Kukës, Divjaka dhe Malësi e Madhe.
- Shërbimet Vendore: Projekti mbledhi informacion të rëndësishëm mbi modelet e ofrimit të shërbimeve vendore, kostot dhe faktorët e tjerë që ndikojnë në efikasitetin dhe aksesin e shërbimeve për qytetarët, të cilat u përpunuan dhe u vlerësuan edhe më tej. Janë duke u përfunduar raportet individuale nga bashkitë si dhe një raport i përgjithshëm mbi veçoritë dhe gjetjet e Ofrimit të Shërbimeve Bashkiake.
- 318 Zyra Vendore të Arkivave dhe Protokollit në 61 bashki po i arkivojnë dokumente sipas standardit të unifikuar për arkivimin fizik. 343 punonjës të arkivave dhe protokollit, ose 80% e numrit të përgjithshëm të tyre, përfituan certifikim të performancës nga ekspertë të GDA bazuar në rezultate. 59 bashki përfunduan procesin e inventarizimit të arkivave për vitin 2017 në përputhje me kërkesat ligjore të arkivave në Republikën e Shqipërisë.



### ***c. Demokracia Vendore: (Pjesëmarrja, Transparenca, Integriteti)***

- Vlerësimi i parë i Qeverisjes Vendore në të 61 bashkitë është kryer në bazë të katër kriterëve të rëndësishme: (i) Efektiviteti dhe Efikasiteti; (ii) Transparenca dhe Rregulli i Ligjit; (iii) Përgjegjësia; (iv) Pjesëmarrja dhe angazhimi i qytetarëve;
- Programi i Transparencës dhe konsultimit publik, i zhvilluar nga STAR2, është miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke e bërë atë të detyrueshëm për të 61 bashkitë. Projekti ka trajnuar 122 zyrtare vendore nga 61 bashkitë për miratimin dhe zbatimin e Programit të ri të transparencës;
- Deri në maj të vitit 2019, të gjitha 61 bashkitë shqiptare kishin faqet e tyre të internetit, me mbështetjen e UNDP, e cila ka mundësuar që 13 bashki ta arrijnë këtë standard;
- Projekti ka mbështetur 33 bashki që të publikojnë Vendimet e Këshillit Bashkiak, duke plotësuar hartën e 61 bashkive me vendime të publikuara;
- 500 zyrtarë të qeverisjes vendore nga të gjitha 61 bashkitë përfituan ndërtimin e kapaciteteve për Angazhimin dhe Konsultimin Publik;
- Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit dhe Kodi Standard i Sjelljes për qeverinë vendore janë të miratuara si standarde nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit;
- 6 bashki: Elbasan, Mat, Mallakastër, Patos, Gjirokastrë dhe Durrës pilotuan Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit. 5 prej tyre miratuan Planin e tyre të Integritetit në Këshillat Bashkiakë përkatës.

### ***d. Zhvillimi i përgjithshëm i burimeve njerëzore:***

- 4475 punonjës bashkiakë nga 61 bashki janë trajnuar në të tre komponentët e projektit. 53.2% e të trajnuarve ishin femra/gra, dhe 21% ishin drejtues të nivelit të lartë.

### ***e. Harta Digjitale e Projekteve dhe Harta e Profileve të Bashkive***

AMVV, duke koordinuar asistencën e dhënë nga partnerët e zhvillimit bashkive, ka priorizuar hartëzimin e kësaj asistencë. Pasja e një harte digjitale të projekteve shërben për të orientuar në të ardhmen më mirë asistencën e partnerëve të zhvillimit, me qëllim pasjen e një asistencë gjithëpërfshirëse në terma rajonale, por edhe në nivel funksioni.

Më konkretisht, AMVV, e asistuar nga projekti STAR 2, ka përgatitur një hartë interaktive me të dhëna statistikore e cila mund të aksesohet online në faqen e Agjencisë. [amvv.qeverisjavendore.gov.al](http://amvv.qeverisjavendore.gov.al). Të dhënat e grumbulluara nga bashkitë në lidhje me projektet dhe donatorët mund të aksesohen shumë lehtë në mënyrë të përmblodhur e të vizualizuara. Informacionet e mbledhura dhe vizualizuara janë: periudha e fillimit dhe mbarimit të projektit, buxheti, agjencia zbatuese, progresi i arritur, aktivitete për këtë projekt, donatorët, personat e kontaktit, bashkia/të në të cilin jep asistencën e saj.

Kjo hartë e gjeneruar nga google së bashku me të dhënat vizualizon të dhënat e përmbledhura në trajtën e një tablele së bashku me hartën e Shqipërisë; projektet dhe aktivitete se bashku me bashkitë ku po zhvillohen këto aktivitete; lidhjen e aktiviteteve me objektivat strategjike; dhe numri i projekteve sipas donatoreve dhe koha e shtrirjes së këtyre projekteve. Harta, vazhdon të popullohet me të dhëna të cilat do ta bëjnë më të aksesueshme dhe më me shumë informacion. AMVV gjykon që pas miratimit të Planit të Veprimit të Strategjisë së Decentralizimit, ky Plan Veprimi do t'i bashkëngjitet si matricë, me qëllim konsolidimin e reformës në pushtetin vendor.

Lidhur me digjitalizimin, AMVV ka në strukturën e saj të integruar platformat si vijon:

- [reformaterritoriale.qeverisjavendore.gov.al](http://reformaterritoriale.qeverisjavendore.gov.al)
- [amvv.qeverisjavendore.gov.al](http://amvv.qeverisjavendore.gov.al)
- [keshillikonsultativ.qeverisjavendore.gov.al](http://keshillikonsultativ.qeverisjavendore.gov.al)
- [platforma-bashkite-per-ne-evrope.ning.com](http://platforma-bashkite-per-ne-evrope.ning.com)
- [praktikatemira.qeverisjavendore.gov.al](http://praktikatemira.qeverisjavendore.gov.al)

Në vitin 2019, AMVV është marrë në mënyrë intesive me hartimin e hartës të profileve të bashkive, e cila është afishuar në faqen zyrtare të AMVV në një nga rubrikat kryesore. Informacionet e mbledhura dhe përpunuara për çdo bashki janë si të aspektit territorial ashtu edhe financiar. Për shembull, Bashkia Tiranë përmban informacione territoriale (sipërfaqen), demografike (popullsinë), administrative (Njësitë Administrative, fshatrat, fshatrat turistike), ekonomike (sektorët kryesore ekonomik dhe aspekte të tjera të lidhura me zhvillimin ekonomik), financiare (të ardhurat dhe shpenzimet vendore) dhe informacione rreth Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak.

## **vi. Vlerësimi i Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore**

AMVV ka dhënë kontributin e saj gjatë fatkeqësisë natyrore të ndodhur nga tërmeti i datës 26.11.2019 duke qenë pjesë e grupeve të punës në këto qarqe të dëmtuara. Në qarkun Durrës, Bashkia Krujë, AMVV ka kontribuar sipas orientimit të Ministrisë së Brendshme, për të asistuar kryetarët e Bashkive në nxjerrjen e Urdhrave për mbrojtjen civile, ngritjen e grupeve të punës për verifikimin, vlerësimin dhe shembjen e 4 pallateve që shkaktuan viktimat në Njësinë Administrative Thumanë të Bashkisë Krujë. Përpunimin e listave të personave që do të strehoheshin në Hoteleritë e paracaktuara si dhe në organizimin e këtyre grupeve për të operuar sipas prioriteteve të diktuar nga KNEC.

Në Qarkun Lezhë, AMVV u caktua me detyrën e mbështetjes dhe me grupe pune në terren ku kontribuoi me dy grupe inspektorësh të AMVV në Qendrën Operacionale të Emergjencave Lezhë, duke kryer verifikimet në terren së bashku me grupet inspektuese për nevojat e të dëmtuarve nga tërmeti i 26.11.2019, në zbatim të udhëzimeve të KNEC-së.

Gjithashtu, në zbatim të vendimit nr. 4, datë 05.12.2019 të Kryetarit të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, në bashkëpunim me UNDP-in, Bashkimin Evropian dhe Bankën Botërore, në datat 17,18.12.2019 u zhvillua trajnimi ndërinstitucional me metodologjinë PDNA (vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë) që përdorin vendet anëtare të

Bashkimit Evropian dhe PNUD-i. Qëllimi i këtij trajnimi është nxjerrja në vlerë monetare e dëmeve dhe kostove të dala nga tërmeti i datës 26.11.2019, për ta paraqitur këtë në formë shkresore në Konferencën e Donatorëve të datës 17.02.2020.

## **vii. Prezantimi i Platformës së Rentës së Industrisë Nxjerrëse**

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur shumë takime tematike, pjesë e analizës me OSCE dhe e draftit përfundimtar, mbi rentën për industrinë nxjerrëse ku janë diskutuar mbi:

- a) Situatën aktuale të rentës minerare dhe tarifave koncesionare në bashki;
- b) Menaxhimin dhe shpërndarjen e rentës, në nivel qendror dhe vendor, Problematika mjedisore;
- c) Problematikat rreth procesit të arkëtimit të rentës minerare, sfidat dhe propozimet;
- d) Paraqitjen dhe diskutimin e draftit përfundimtar të dokumentit të politikave për rentën minerare;
- e) Planin e Veprimit të platformës për rentën minerare për vitin 2020.

AMVV, si pjesë e kësaj platformë diskutimi, ka analizuar nga këndvështrimi teknik procesin e shpërndarjes së rentës minerare në bashkitë përfituese. Platforma shtron opsionin e ndryshimit të rentës dhe tarifave të tjera, që bashkitë të përfitojnë nga burimet e veta natyrore. Gjithashtu, nxit bashkëpunimin midis pushtetit vendor dhe kompanive minerare dhe naft-nxjerrëse. Në këtë kontekst, AMVV do të mbështesë bashkitë si në ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve për rentën dhe të propozimeve për rritjen e saj nëpërmjet paraqitjes së propozimeve dhe diskutimit në Këshillin Konsultativ, me sugjerimet.

## **viii. Rregullorja e Këshillave Bashkiak**

Agjencia, në bashkëpunim me projektin Bashkitë e Forta, kanë hartuar rregullore për funksionimin e Këshillave Bashkiak, e cila u është dërguar 61 bashkive në Republikën e Shqipërisë për të mundësuar njësimin e procedurave të këshillave bashkiak në të gjithë territorin. Gjatë 2019, 15 këshilla bashkiak e miratuan këtë rregullore, ndërkohë ishin në proces miratimi 6 këshilla bashkiak. Pritet që në vijim kjo rregullore të miratohet në të gjitha këshillat bashkiak duke standardizuar kështu procedurat e punës në këshillat bashkiak në të gjithë territorin.

## **ix. Sfidat**

1. Monitorimi dhe ndjekja me të gjithë bashkitë e miratimit të urdhrave të ngritjes së Njësive të Integritimit Evropian.
2. Rritja e bashkëpunimit me shoqatat dhe aktorët vendorë, shoqërinë civile dhe donatorët për përmbushjen ligjore dhe nënligjore të Këshillit Konsultativ nëpërmjet Sekretariatit Teknik të këtij Këshilli.

3. Organizimi i trajnimeve me qëllim ngritjen e kapaciteteve të stafeve të AMVV dhe Ministrisë së Brendshme për proceset e Integritimit Evropian.
4. Organizimi i trajnimeve me qëllim ngritjen e kapaciteteve të zyrave të Integritimit Evropian në nivel vendor.
5. Ndjekja e vazhdueshme me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me problemet që bashkitë hasin lidhur me menaxhimin/disbursimin e fondeve të BE.
6. Mbështetje për organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësimit të komunitetit mbi rolin e qeverisjes vendore në procesin e Integritimit Evropian.
7. Mbështetje bashkive për organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese për komunitetin lidhur me politikën sektoriale të Bashkimit Evropian (Legjislacioni BE-së-EU *Acquis*) të cilat zbatohen nga niveli vendor.
8. Rritja e nivelit të performancës së të organeve të NJVV-e nëpërmjet monitorimit të zbatimit të ligjit për “Vetëqeverisjen Vendore” dhe “Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore”.
9. Përbushja e akteve ligjore dhe nënligjore nga Ministritë, të standarteve për funksionet e decentralizuara.
10. Rritja e rolit të NJVV në Këshillat Vendore të Sigurisë Publike
11. Procesi i emërimit të rrugëve, shesheve, bulevardëve në bashki
12. Renta Minerare. Miratimi i tarifës së rentës minerare nga 5% të taksës, në 50%, i Fi koncesionare për HEC nga 0 në 50%, të miratohet detyrimi i PPP dhe investitoreve të HEC etj, për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për bashkitë, detyrimi i përdorimit të fondit të rehabilitimit të mjedisit dhe fondit të garancisë, sipas dhe sugjerimeve të OSCE-së.